

Të nderuar Aplikantë,

Duke ju falenderuar për interesimin e treguar për programin e Granteve të Fondacionit Vodafone Albania, po ju paraqesim më poshtë listën e dokumentave që Organizata aplikuese duhet të dorëzojë së bashku me Projekt- propozimin dhe Formën e Aplikimit për Grant (informacion mbi të cilat mund ta gjeni duke kontaktuar me zyrën e Fondacionit):

1. Kopje të **Akti i themelimit** të Organizatës;
2. Kopje të **Vendimit të Gjykatës** për regjistrimin e Organizatës. Ju lutem të paraqitni vendimin e parë. Në rast se Organizata ka regjistruar në Gjykatë ndryshime të mëvonshme, duhet paraqitur edhe vendimi më i fundit;
3. Kopje e **Statutit** të Organizatës (varianti më i fundit);
4. Dokument vërtetimi nga **Banka** me të cilën operon organizata ku përfshihen:
  - a) Vërtetim për **Llogarinë Bankare** në Lekë (ALL).  
**Shënim:** Duke qënë se Fondacioni Vodafone Albania operon me AlphaBank, do të ishte e rekomanduar që organizata të operonte nëpërmjet kësaj banke me qëllim për të ulur kostot e transaksioneve të cilat në çdo rast nuk mbulohen nga Fondacioni;
  - b) Vërtetim nga Banka ku operon organizata se për çdo veprim nevojiten të paktën **dy firma** nga personat e autorizuar.  
**Shënim:** Në mënyrë specifike vërtetimi i Bankës duhet të përmbajë tekstin: “për çdo veprim nevojiten jo më pak se dy firma nga personat e autorizuar...”.
5. Kopje e **NIPT-it**
6. Vërtetim nga Drejtoria e Tatim Taksave që Organizata nuk ka **detyrime të pashlyera** përsa i përket kontributeve, përfshirë sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatim-taksat;
7. **Deklarate** e lëshuar nga përfaqësuesi i autorizuar i organizatës aplikuese mbi vërtetësinë e dokumentave të dorëzuara prej organizatës.

Fondacioni Vodafone Albania rezervon te drejten për të kërkuar dokumenta të tjera shtesë nëse është e nevojshme.

#### **E RËNDËSISHME:**

Si në dokumentat e dorëzuara ashtu dhe në formën e aplikimit, kërkohet që emri i Organizatës të jetë i njëjtë dhe i pandryshuar (duke përjashtuar këtu rastet kur ndryshimet regjistrohen me vendim gjykatë). Duke qënë se forma e aplikimit paraqitet në gjuhën angleze, përbri emrit të Organizatës tuaj në formën e aplikimit mund të vendosni në kllapa edhe përkthimin e këtij emri në anglisht (nese emertimi sipas vendimit të gjykatës është në një gjuhë tjetër).

**Nëse Organizata e juaj perzgjidhet nga Fondacioni Vodafone Albania për zbatimin e projektit të propozuar, atëherë kërkohet që të dorëzohen:**

- i. Dokumentat e sipërpërmenduar të noterizuara prej jush përpara se të firmoset Marrëveshja mes Fondacionit dhe Organizatës zbatuese, në mënyrë që të vërtetohet njësimi i kopjes me origjinalin.
- ii. Varianti në gjuhën shqipe të formës së aplikimit, gjë që do të bashkëngjitet Marrëveshjes mes Fondacionit dhe Organizatës zbatuese.
- iii. kopje e noterizuar e bilancit financiar më të fundit në mënyrë që të evidentohet se Organizata nuk e ka mbyllur vitin e fundit financiar si debitore.

Për çdo informacion dhe pyetje që mund te keni, na kontaktoni si më poshtë: